

Futbollit Vllaznia

256705004N

2141016

141

3333

Nr. i Kuponit 222110

URDHER - SHPENZIMI

NR 79

12.09.2011

Nr. i Punonjseve

Nr.	Struktura e llogarive						SHUMA ne Leke	Objekti i shpenzimit
	Gr.	Kap.	Kod Program	Llogaria Ekonomike	Nen Llogaria	Kod Projekti		
1	0	5	8140	604	6040009		2,000,000.00	<u>Te tjera transferime korrente</u>
2								
3								
4								
5								
6								
7								
8								
9								
10								
11								
12								

TOTALI ME SHIFRA						Dymilion		
TOTALI ME FJALE								

Te dhena per kreditorin perfutues :

Emri i perfutuesit	
Klubi Futbollit Vllaznia SH.A	
NIPT - i	L 17029001S
IBAN	AI 75206510170000600313237100
Emri Bankes	Tirana Bank

Dokumentat ngjitur Urdher Shpenzimit :

Emertimi	Nr. Dokument	Date Dokumenti
Cek		
Xhirim		
Nr i Urdherit te blerjes		
Te tjera (Emertime, numer date)		V.K.B. nr 9 dt 26.08.2011 Akt Themelimi dt 28.08.2011 Statuti dt 26.08.2011 Ekstrakti I regjistrimit, Certifikata Regjis trimi Numri serial SN-129406 -08-11

PER INSTITUCIONIN

PER DEGEN E THESARIT

URDHERUESI

[Signature]



KONTABILISTI

[Signature]

Approvuar date 12.09.2011

NEPUNESI I THESARIT

[Signature]

Vula

Shenim: Qelizat per "Nr. i kuponit dhe "Aprovuar date", plotesohen nga nepunesi i Deges se Thesarit
 Formati i ketij Urdher Shpenzimi eshte miratuar nga Ministri i Financave me shkresen nr. 6153 date 27.05.2009



Klubi i Futbollit "Vllaznia" sh.a.
Shkodër - Albania

Adresa: Stadiumi "Loro Boriçi" Rr. "Djepaxhiqej" Nr 2, Shkodër / Albania Tel: +355 2024 2305 Fax: +355 202 47514 / 43720

VENDIM
Nr.1 date 11.10.2011

Sot me dt 11.10.2011 Une, Lorenc LUKA, Ortak i vetem i shoqerise aksionere "KF Vllaznia"sh.a., e rregjistruar si person juridik ne QKR me date 29.08.2011 me NUIS-L17029001S, me seli ne Rr.Djepaxhiqej, Nr 2, Shkoder,ne mbeshtetje edhe te vendimit te Keshillit Bashkiak Shkoder nr 19,date 29.09.2011 per aprovimin e fondit prej 6 milion leke per shtim kapitali te shoqerise aksionere "KF Vllaznia"sh.a.

vendosa

1. Zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise aksionere "KF Vllaznia"sh.a., me vlere 6.000.000 lek. Ky zmadhim behet me emetim te 6000 (gjashte mije)aksioneve te reja me vlere nominale te pa ndryshueshme 1000 (njemije) lek per aksion. Numari total i aksioneve behet 8000 (tete mije) aksione me vlere nominale te pa ndryshueshme 1000 (njemije) lek per aksion.
2. Depozitimn nga ana e administratorit ligjor te shoqerise aksionere "KF Vllaznia"sh.a., z. Kujtim Shaba te ketij vendimi prane QKR-se se bashku me praktiken e vendimit te Keshillit Bashkiak Shkoder nr 19,date 29.09.2011.

Ortaku i vetem i Shoqerise
Lorenc LUKA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA SHKODER



AUTENTIFIKIM NENSHKRIMI

Rep.Nr. 1533

Sot me dt.11.10.2011 ne zyren e noterise Shkoder para meje noterres Lunturi Hoxha u paraqit personalisht z.Lorenc LUKA.

Per identitetin e te cilit u sigurova ne baze te Kartes se Identiteti _____ e pasi u binda se i ka aftesite qe i kerkon ligja i vertetes nenshkrimet e mesiperme.



NOTERE
Lunturi Hoxha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
SHKODËR

Bashkia Shkodër, Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër; Tel +355 224 7273 keshilli.bashkia@yaho.com

Nr. 19/prot.

Shkodër, me 05.10.2011

Lënda: Dërgim Vendimi

Drejtuar: Prefektura e Qarkut Shkodër
Drejtoria ekonomike
Drejtoria Juridike
Drejtoria e Kulturë-Sport

Bashkëlidhur Ju dërgojmë Vendimin e Këshillit të Bashkisë Shkodër.
Vendimi nr. 19, datë 29.09.2011.

Sekretare e Këshillit
Ilirjana PIRANI

VERIETONE! NJESIA
ME ORIGINALIN
KRYETARI
LORENC LUKA
Date: 11/10/2011

V E N D I M
Nr. 19, datë 29.09.2011

Dhënie fondi për zmadhim kapitali themeltar me emetim të aksioneve të reja

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës 29.09.2011, me propozim të Kryetarit të Bashkisë dhe në mbështetje të ligjit nr. 8652, dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" nëni 19 pika 9, nëni 32 pika d, nëni 33 pika 3 me ndryshimet përkatëse, VKB nr. 9936 dt. 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", VKB nr. 53 dt. 26.03.2011 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2011", statutit të Klubit Futboll Vllaznia sh.a nëni 9 dhe ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" nëni 135 dhe 173, pasi shqyrtoi relacionin përkatës dhe pas diskutimit të anëtarëve:

V E N D O S I

1. Të miratojë pakësimin në shumën 6 000 mije leke si më poshtë:
Nga tepricat e diferencave në mes vlerave të parashikuara të zbatimit me vlerat e kontratave të operatorëve fitues për objektet e prokuruarra gjatë vitit 2011 (zeri investime) art. 231 si më poshtë:

Sistemim blloku I pallateve Zogu i I-rë	953 000 leke
Zbatim	939 000 leke
Mbikqyrje	13 300 leke
Kolaudim	700 leke

Sistemim blloku i pallateve ish fusha e lëkurave	2 095 000 leke
Zbatim	2 067 400 leke
Mbikqyrje	25 600 leke
Kolaudim	2 000 leke

Sistemim blloqe pallate Ali Pashë Guçia	322 000 leke
Zbatim	322 000 leke
Mbikqyrje	0 leke
Kolaudim	0 leke

VERIETONE! NJESIA
ME ORIGINALIN
KRYETARI
LORENC LUKA
Date: 11/10/2011

Ndricim rrugë dytësore	955 000 leke
Zbatim	939 500 leke
Mbikqyrje	13 300 leke
Kolaudim	2 000 leke

Ndricim rrugë Daniel Matlia	1 675 000 leke
Zbatim	1 650 000 leke
Mbikqyrje	23 000 leke
Kolaudim	2 000 leke

2. Të miratojë shtesën në programin 8140 art. 604 (Bashkia Shkodër) për dhënie fondi për zmadhimin e kapitalit themeltar në emetim të aksioneve të reja për "KF Vllaznia" sh.a me vlerë 6 000 mije leke.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes së ligjshmerisë nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër.

KRYETARI
Bardhy LOHJA

VERIETONE! NJESIA
ME ORIGINALIN
KRYETARI
LORENC LUKA
Date: 11/10/2011

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETARI

Bulevardi "13 Dhjetori" Shkodër, Albania Tel & Fax 355-224 37-20

Nr. _____ prot.

Shkodër, me _____ 2011

L e n d a : Miratim për dhënie fondi prej 6 000 mije leke për zmadhim kapitali themeltar
Me emetim të aksioneve të reja në favor të KF Vllaznia sh.a.

Drejtuar : Këshillit Bashkiak Shkodër

Bashkangjitur ju dërgojmë materialin përkatës relacion dhe projekt – vendim.

KRYETARI BASHKISE
LORENC LUKA

VERIETONE! NJESIA
ME ORIGINALIN
KRYETARI
LORENC LUKA
Date: 11/10/2011

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA JURIDIKE

Rruga "13 Dhjetori" Shkodër, Albania Tel & Fax 355-224 37-20

R E L A C I O N

Drejtuar: Këshillit Bashkisë Shkodër

Lënda: Dhënie fondi për zmadhim kapitali themeltar me emetim të aksioneve të reja

Te nderuar keshilltare,

Bashkia Shkodër parashtron kërkesën për zmadhim kapitali themeltar të KF Vllaznia sh.a. në shumën 6.000.000 (gjashtë milion) lek. Një kërkesë të tillë e gjejmë të bazuar në nenin 9 të statutit të kesaj shoqërie, në ligjin nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" përkatësisht në nenin 135 dhe 173 e vijues, si dhe në ligjin nr.8652, date 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" nëni 32, pika d. Kërkesa për shtesë kapitali vjen si domosdoshmeri për të përballuar detyrimet aktuale të funksionimit të KF Vllaznia sh.a., me aksioner të vetëm Bashkia Shkodër.

Kapitali themeltar i krijimit të kesaj shoqërie aprovuar me VKB nr 9 dt 26/08/2011 është 2 milion lek i ndare në 2000 aksione të se njetes kategori me vlerë nominale prej 1000 (nje mije) lek, për çdo aksion të shlyer për teresinë e vleres nominale. Me shtesën e kapitalit themeltar me shumën 6.000.000 (gjashtë milion) lek, kapitali themeltar rriten në 8.000.000 (tetemiljon) leke, dhe numri i aksioneve rriten nga 2000 (dy mije) në 8000 (tete mije) aksione të se njetes kategori me vlerë nominale prej 1000 (nje mije) lek.

Burimi i financimit propozojmë të jetë nga fondet teprice nga investimet me të ardhurat e Bashkisë Shkodër si diferencave mes fondit limit të tenderuar dhe ofertes fituese të kontraktuar.

Bazuar sa me sipër i kërkohej këtij Keshilli, miratimi i projekt vendimit që të bashkëngjitet këtij relacioni, ku kërkohej miratimi i fondit për rritje kapitali themeltar të KF Vllaznia sh.a. në shumën 6.000.000 (gjashtë milion) lek me emetim të aksioneve të reja.

VERIETONE! NJESIA
ME ORIGINALIN
KRYETARI
LORENC LUKA
Date: 11/10/2011

Drejtor
Marjeta GJELUCI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I BASHKISË
SHKODËR

Bulevardi "13 Dhjetori" Shkodër, Albania Tel & Fax 355-224 37-20

Nr. _____ prot.

Shkodër, me ____/____/2011

PROJEKT-V E N D I M

Mbi disa ndryshime të V.K.B. nr. 53 date 26.03.2011

Këshilli i Bashkisë Shkodër në mbledhjen e tij të datës _____ 2011, me propozim të Kryetarit të Bashkisë dhe në mbështetje të ligjit nr. 8652 date 31.07.2000 "Për Qeverisjen dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", nëni nr. 33, pika 2, me ndryshimet përkatëse, ligjit nr. 9936 date 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", si dhe V.K.B. nr. 53 date 26.03.2011 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2011", nëni 9 i statutit të "Klubit të Futbollit Vllaznia" sh.a dhe ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" nëni 135 dhe 173, pasi shqyrtoi materialin e parqitur dhe mbas diskutimeve të anëtarëve:

V E N D O S I:

1. Të miratojë pakësimin në shumën 6.000 mije lek si më poshtë:

Nga tepricat e diferencave në mes vlerave të parashikuara të zbatimit me vlerat e kontratave të operatorëve fitues për objektet e prokuruarra gjatë vitit 2011 (zeri investime) art.231 si më poshtë:

Sistemim blloku i pallateve Zogu i I-re	953 000 leke
Zbatim	939 000 leke
Mbikqyrje	13 300 leke
Kolaudim	700 leke

Sistemim blloku i pallateve ish fusha e lëkurave	2 095 000 leke
Zbatim	2 067 400 leke
Mbikqyrje	25 600 leke
Kolaudim	2 000 leke

Sistemim blloqe pallate Ali Pashe Guçia	322 000 leke
Zbatim	322 000 leke
Mbikqyrje	0 leke
Kolaudim	0 leke

Ndricim rrugë dytësore	955 000 leke
Zbatim	939 500 leke
Mbikqyrje	13 300 leke
Kolaudim	2 000 leke

Ndricim rruga Daniel Matlia	1 675 000 leke
Zbatim	1 650 000 leke
Mbikqyrje	23 000 leke
Kolaudim	2 000 leke

2. Të miratojë shtesën në programin 8140 art.604 (Bashkia Shkodër) për dhënie fondi për zmadhimin e kapitalit themeltar në emetim të aksioneve të reja për "KF Vllaznia" sh.a me vlerë 6.000 mije leke.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

4. Ky Vendim hyn në fuqi pas shpalljes së ligjshmerisë nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër

Konceptoi Alfred Luleta
Elena Zorba

Miratoi Ridvan Troshani

Kaloi në Drejt. Ekonomike

Kaloi në Drejt. Juridike

VERIETONE! NJESIA
ME ORIGINALIN
KRYETARI
LORENC LUKA
Date: 11/10/2011

Sekretari i Përgjithshëm
Fatbardh Sheqi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QARKU SHKODËR
PREFEKTI

Nr. Prot
1495/11

Shkodër, me _____ 2011

Lënda: Lidhur me vendimin Nr.19, datë 29.09.2011 të Këshillit të Bashkisë Shkodër.

Drejtuar Këshillit Bashkisë Shkodër

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale përcaktuar në dispozitat e ligjit Nr. 8927 datë -25.07.2002 "Për Prefektin", nëni 14, paragrafi 2, ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", nëni 19, pika 9, nëni 32 germa dh, nëni 33 pika 3, ligji nr.10355 datë 02.12.2010 "për buxhetin e vitit 2011" si dhe Udhëzimin nr.4 datë 27.01.2011 e Ministrisë Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011", ligjit Nr.9901 dt.14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", shqyrtoi vendimin Nr.19 datë 29.09.2011 të Këshillit të Bashkisë Shkodër.

" Mbi miratimin e pakësimit në shumën 6 000 mije lekë (nga tepricat e diferencave në mes vlerave të parashikuara të zbatimit me vlerat e kontratave të operatorëve fitues për objektet e prokuruarra gjatë vitit 2011 (zeri i investime) art.231 në shumën 6000 mije leke dhe shtesën në programin 8140 art.604 (Bashkia Shkodër), për dhënie fondi për zmadhimin e kapitalit fillestar në emetim të aksioneve të reja për "KF Vllaznia" sh.a me vlerë 6 000 mije leke".

Pas analizës ligjore Prefekti shprehet pozitivisht dhe ju autorizon të procedoni.

Me respekt,

VERIETONE! NJESIA
ME ORIGINALIN
KRYETARI
LORENC LUKA
Date: 11/10/2011

Sekretari i Përgjithshëm
Fatbardh Sheqi

Institucioni
NIPT - i
Kod Institucioni
Entiteti i Qeverisjes
Distrikti (TDO)

Bashkia Shkoder
K36813001H
2141001
141
3333

Bashkia
201 833

Nr. i Kuponit

URDHER - SHPENZIMI

NR. DATE

Nr.i Punonjseve

Nr.	Struktura e llogarive						SHUMA ne Leke	Objekti i shpenzimit
	Gr.	Kap.	Kod Program	Llogaria Ekonomik	Nen Llogaria	Kod Projekti		
1	0	5	8140	604	6040009	6.000.000.00	pagese fondi per zmadhim kapitali themeltar	
2								
3								
4								
5								
6								
7								
8								
9								
10								
11								
12								

TOTALI ME SHIFRA 6,000,000.00 X

TOTALI ME FJALE

gjashtemilion
leke

Te dhena per kreditorin perfitues :

Emri i perfituesit	
KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA SH.A	
Nipt	L17029001S
Nr.llog.bank	AL75206510170000600313237100
Emri Bankes	Tirana Bank
Adresa e Bankes	Shkoder

Dokumentat ngjitur Urdher Shpenzimit :

Emertimi	Nr. Dokument	Date Dokumenti
Cek		
Xhirim		
Nr i Urdherit te blerjes		
Te tjera (Emertime, numer date)	UB Nr 105, dt.18.10.2011 VKB nr19, dt.29.9.2011, shprehje ligj nr1795/1prot, dt.10.10.2011 Akt themelimi i Shoqerise nr1220,nr868kol,dt.28.8.11 Statuti i shoqerise nr rep 1221,nr kol 869, dt.26.8.11 ekstrakt qkr dt.18.10.2011 certifikate rregjistrimi dt.29.8.2011, numer serial SN-129406-08-11 Vendim Zmadhimi kapitali themeltarNr1, dt.11.10.11	

PER INSTITUCIONIN

PER DEGENE T HESARIT

URDHERUESI
[Signature]
Vula

KONTABILISTI
[Signature]
Vula

Aprovuar date *20.10.2011*
NEPUNESI I THESARIT
[Signature]
Vula

Shenim: Qelizat per Nr. i kuponit dhe "Aprovuar date", plotesohen nga nepunesi i Deges se Thesarit
Formati i ketij Urdher Shpenzimi eshte miratuar nga Ministri i Financave me shkresen nr. 6153 date 27.05.2009



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
SHKODËR

Bashkia Shkodër, Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër; Tëll +355 224 7273 keshilli.bashkia@vahoo.it

V E N D I M

Nr. 23, datë 10.10.2011

Miratim ndryshim destinacionit të zhpenzimeve brenda fondit të miratuar me VKB nr. 53 dt. 26.03.2011

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës 29.09.2011, me propozim të Kryetarit të Bashkisë dhe në mbështetje të ligjit nr. 8652, dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 19 pika 9, neni 32 pika d, neni 33 pika 2 me ndryshimet përkatëse, ligjit nr. 9936 dt. "Për menaxhimin e sistemit buxhetor", ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" neni 135 dhe 137, statusi i KFVllaznia sh.a neni 9, si dhe të VKB nr. 53 dt. 26.03.2011 "Miratimi i buxhetit të bashkisë për vitin 2011", mbas shqyrtimit të relacionit të paraqitur nga Drejtoria e Kulturës-Sport dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

V E N D O S I

1. Të miratojë ndryshimin e destinacionit të shpenzimeve brenda fondit të miratuar me VKB nr. 53 dt. 26.03.2011, sipas zërave më poshtë:

Paksim

Programi 9240, Arsim Bashkia -Zëri investime (art. 231)

Rikonstruksion ambjente sanitare shkolla Skenderbeg 5.677.000leke

Sistemim oborri shkolla Mati Logoreci (diferenca) 390.545leke

Sistemim sheshi shkolla Bahcallek (diferenca) 770.215leke

Programi 8140, Sport Klub Vllaznia-zëri investime (art.231)

Riabilitim i zyrave të Pallatit Sportit (diferenca) 362.240leke

Programi 10140, Bashkia Shkoder-zëri transferime (art.604)

Sektori shërbime sociale 2800000leke

Totali 10. 000. 000 leke

Shtesë

Programi 8140, Bashkia Shkoder (art. 604) për dhënjën e fondit për zmadhimin e kapitalit themeltar në emëtimin e aksioneve të reja për KFVllaznia sh.a me vlerë **10.000.000 leke**

2. Burimi i financimit do të jetë fondi i miratuar me VKB nr. 53 dt. 26.03.2011
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drej. Ekonomike, Drej. Kulturë-Sport.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes së ligjshmërisë nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Shkoder.

KRYETARI

Bardhy LOHJA



Institucioni Bashkia Shkoder
 NIPT - i K36813001H
 Kod Institucioni 2141001
 Entiteti i Qeverisjes 141
 Distrikti (TDO) 3333

Nr. i Kuponit

Bashkia Shkoder
 269 PP4

URDHER - SHPENZIMI

NR. 647

DATE 26.10.2011

Nr. i Punonjseve

Nr.	Struktura e llogarive						SHUMA ne Leke	Objekti i shpenzimit
	Gr.	Kap.	Kod Program	Llogaria Ekonomik	Nen Llogaria	Kod Projekti		
1	0	5	8140	604	6040009		10,000,000.00	pagese fondi per zmadhim kapitali themeltar
2								
3								
4								
5								
6								
7								
8								
9								
10								
11								
12								

TOTALI ME SHIFRA

10,000,000.00

X

TOTALI ME FJALE

dhjetemilion
leke

Te dhena per kreditorin perfutues :

Emri i perfutuesit	KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA SH.A
Nipt	L17029001S
Nr.llog.bank	AL75206510170000600313237100
Emri Bankes	Tirana Bank
Adresa e Bankes	Shkoder

Dokumentat ngjitur Urdher Shpenzimit :

Emertimi	Nr. Dokument	Date Dokumenti
Çek		
Xhirim		
Nr i Urdherit te blerjes		
Te tjera (Emertime, numer date)	Urdher Brendshem Nr 108, dt.21.10.2011 VKB nr23, dt.10.10.2011, shprehje ligji nr1825Prot dt.20.10.2011 Akt themelimi i Shoqerise nr1220,nr868kol,dt.28.8.11 Statuti i shoqerise nr rep 1221,nr kol 869, dt.26.8.11 çertifikate rregjistrimi dt.29.8.2011, numer serial SN-129406-08-11 Vendim Zmadhimi kapitali themeltarNr2, dt.20.10.11	

PER INSTITUCIONIN

PER DEGEN E THESARIT

URDHERUESI

KONTABILISTI

Aprovuar date

NEPUNESI I THESARIT

[Signature]
Vula

[Signature]
Vula

[Signature]
Vula

Shenim: Qelizat per "Nr. i Kuponit" dhe "Aprovuar date", plotesohen nga nepunesi i Deges se Thesarit

Formati i ketj Urdher Shpenzimi eshte miratuar nga Ministri i Financave me shkresen nr. 6153 date 27.05.2009



**Klubi i Futbollit VLLAZNIA sh . a
Shkoder**

Adresa : Stadiumi Loro Boriçi, Rr. Djepaxhijej, Nr. 2 Shkoder / Albania

Tel: +355 2224 2305; Fax: +355 222 47514 / 43720

V E N D I M

Nr 4 , Dt. 03.05 . 2012

Sot me datë 03.05.2012, Unë, Lorenc LUKA, me cilësinë e përfaqesut të ortakut të vetëm Bashkia Shkoder të shoqërisë aksionare „Klubi i Futbollit Vllaznia“ sh.a, e regjistruar si person juridik në QKR me date 29.08.2011 me NUIS – L17029001S, me seli në Rr. Djepaxhijej, Nr. 2, Shkoder, në mbështetje të ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 „Per tregtaret dhe shoqërite tregtare“, si dhe të vendimit Nr. 20, date 06.04.2012 „Për miratim fondi në shumën prej 25.000.000 leke për shtim kapitali themeltar në emetim të aksioneve të reja në favor të K.F.Vllaznia sh.a“,

V E N D O S A

1. Zmadhimin e kapitalit themeltar të shoqërisë aksionare „K.F.Vllaznia“ sh.a, me vlere 25.000.000 (njetzet e pese milion) leke.
2. Kjo shumë do të transferohet në dy këste, kësti i parë prej 15.000.000 (pesëmbëdhjete milion) leke brenda 3-mujorit të parë të vitit 2012 dhe kësti i dytë prej 10.000.000 (dhjete milion) leke brenda 3-mujorit të dytë të vitit 2012.
3. Kapitali themeltar rritet me 25.000 (njetzet e pese mije) aksione të së njëjtes kategori me vlere nominale të pandryshueshme 1000 (njemije) leke për aksion.
4. Numri total i aksioneve bëhet 301.900 (treqind e njëmije e nëntëqind) me vlere nominale të pandryshueshme 1000 (njemije) leke për aksion.
5. Depozitim nga ana e administratorit ligjor të shoqërisë aksionare „K.F.Vllaznia“ sh.a, z. Kujtim Shaba të këtij vendimi pranë QKR-së së bashku me praktiken e vendimit Nr. 20, datë 06.04.2012 të Këshillit të Bashkise Shkodër.

Ortaku i vetëm i shoqërisë
Bashkia Shkoder
përfaqesuar nga Kryetari
Lorenc LUKA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA SHKODER

Rep. Nr. 1660

AUTENTIFIKIM NENSHKRIMI

Sot, me dare 03.05.2012, në zyrën e noterisë Shkoder, para meje notere Lumturi Hoxha, u paraqit personalisht z. Lorenc LUKA, për identitetin e të cilit u sigurova në baze të kartës së identitetit nr. _____, e pasi u binda se i ka të gjitha aftësitë e kerkuara nga ligji, i vertetova nënshkrimin e mesiperm.

NOTERE
Lumturi HOXHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
SHKODËR

Bashkia Shkodër, Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër; Tëll +355 224 7273 keshilli.bashkiak@yahoo.it

V E N D I M

Nr. 20, datë 06.04.2012

Miratim fondi në shumën prej 25.000.000 lek për shtim kapitali themeltar në emëtim të aksioneve të reja në favor të KF Vllaznia sh.a

Këshilli Bashkisë Shkodër në mbledhjen e tij të datës 06.04.2012, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të ligjit 8652 dt. 31.07.2000 "Për Organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore" neni 32 pika d, dhe ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 „Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare“ neni 135 dhe 173 e vijues, pas shqyrtimit të relacionit dhe pas diskutimit të anëtarëve:

V E N D O S I

1. Të miratojë fondin në shumën prej 25.000.000 (njëzet e pesë milion)leke për shtim kapitali themeltar në emëtim të aksioneve të reja në favor të KF Vllaznia sh.a.
2. Kjo shumë do të transferohet në dy këste, kësti I parë prej 15.000.000 (pesëmbëdhjetë milion) leke brenda 3 mujorit të parë të vitit 2012 dhe kësti I dytë prej 10.000.000 (dhjetë milion) leke brenda 3 mujroti të dytë të vitit 2012.
3. Kapitali themeltar rritet me 25000 (njëzet e pesë mijë) aksione të së njëjtës kategori me vlerë nominale të pandryshueshme 1000 (njemije) lek për aksion.
4. Burimi i financimit do të jetë Buxheti i vitit 2012.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes së ligjshmërisë nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër.

KONTROLET NJESIA
ME ORIGINALIN
KRYETARI
LORENC LUKA
Date: 15/06/2012



KRYETARI
Bardhyl LOHJA

Nr. 20/1201
dt 24.04.12



100 Vjet Pavarësi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QARKU SHKODËR
PREFEKTI

Nr.752/1 .Prot.

Shkodër me, 23 /04 /2012

Lënda: Lidhur me vendimin nr.20 datë 6.04.2012 të Këshillit të Bashkisë Shkodër.

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Shkodër.

Prefekti i qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale përcaktuar në dispozitat e ligjit nr.8927, datë 25.07.2002 "Për Prefektin", neni 14, paragrafi 2, ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32, pika dh, neni 33/3, ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, neni 135, 173, shqyrtoi vendimin nr.20 dt.6.04.2012 të këshillit të Bashkisë Shkodër "Mbi përdorimin e shumës prej 25.000.000 (njëzet e pesë milion) lekësh për shtim kapitali themeltar në emetim të aksioneve të reja në favor të klubit Vllaznia sh.a, me vlerë nominale të pandryshueshme 1000 (njemije) lekë per aksion, marrë nga buxheti i vitit 2012, shumë kjo që do të transferohet në 2 këste, kësti i parë prej 15.000.000 lekësh brenda 3-mujorit të parë të vitit 2012 dhe kësti i dytë 10.000.000 lekësh brenda 3-mujorit të dytë të vitit 2012".

Pas shqyrtimit ligjor, Prefekti ju autorizon të procedoni konform procedurave të mëtejshme ligjore.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KONTROLET NJESIA
ME ORIGINALIN
KRYETARI
LORENC LUKA
Date: 15/06/2012



PREFEKTI

Vollana ADEMI

Adresa: "Rruga 28 Nëntori" Shkodër, Tëll/Faks.00355 2224 2705, e-mail: prefekturashkoder@yahoo.com



Institucioni Bashkia Shkoder
 NIPT - i K36813001H
 Kod Institucioni 2141001
 Entiteti i Qeverisjes 141
 Distrikti (TDO) 3333

17

Nr. i Kuponit 105132

URDHER - SHPENZIMI

NR. 231 DATE 4.05.2012

Nr. i Punonjseve

Nr.	Struktura e llogarive						SHUMA ne Leke	Objekti i shpenzimit
	Gr.	Kap.	Kod Program	Llogaria Ekonomik	Nen Llogaria	Kod Projekti		
1	0	5	8140	604	6040009	15.000.000,00	Pagese fondi per zmadhim kapitali themeltar	
2								
3								
4								
5								
6								
7								
8								
9								
10								
11								
12								

TOTALI ME SHIFRA 15.000.000,00 X

TOTALI ME FJALE pesembdhjetemilion

Te dhena per kreditorin perfutues :
 Emri i perfutuesit Klubi Futbollit Vllaznia sha
 Nipt L17029001S
 IBAN AL75206510170000600313237100
 Emri Bankes Tirana Bank
 Adresa e Bankes Shkoder

Dokumentat ngjitur Urdher Shpenzimit :

Emertimi	Nr. Dokument	Date Dokumenti
Çek		
Xhirim		
Nr i Urdherit te blerjes		
Te tjera (Emertime, numer date)	U.brend nr.41 dt.3.05.2012 VKB nr.14 dt.12.03.2012 "detajimi buxhetit 2012 fq.110" Sh.ligjsh nr.608 dt.27.03.2012 Akt themelimi nr.1220 nr.868kol dt.28.8.2011 Statusi i shoqerise nr.rep 1221 nrkol 869 dt.26.8.2011 Ekstrakti QKR dt.12.04.2012 Vendim zmadhimi kapitali nr.4 dt.3.05.2012	

PER INSTITUCIONIN

PER DEGEN E THESARIT

URDHERUESI
[Signature]
 Vula

KONTABILISTI
[Signature]
 Vula

Aprovuar date 4.5.2012
 NEPUNESIT THESARIT
[Signature]
 Vula

Shenim: Qelizat per "Nr. i kuponit" dhe "Aprovuar date", plotesohen nga nepunesi i Deges se Thesarit
 Formati i ketij Urdher Shpenzimi eshte miratuar nga Ministri i Financave me shkresen nr. 6153 date 27.05.2009



Nr. i Kuponit 145806

URDHER - SHPENZIMI

NR. 431

DATE 18,06,2012

konjseve

Nr.	Struktura e llogarive						SHUMA ne Leke	Objekti i shpenzimit
	Gr.	Kap.	Kod Program	Llogaria Ekonomik	Nen Llogaria	Kod Projekti		
1	0	5	8140	604	6040009	10.000.000,00	Pagese fondi per zmadhim kapitali	
2								
3								
4								
5								
6								
7								
8								
9								
10								
11								
12								

TOTALI ME SHIFRA

10.000.000,00

X

TOTALI ME FJALE

dhjetemilion

Te dhena per kreditorin perfitesit :

Emri i perfitesit	
Klubi i Futbollit Vllaznia sha	
Nipt	L17029001S
Nr.llog.bank	AL75206510170000600313237100
Emri Bankes	Tirana Bank
Adresa e Bankes	
Shkoder	

Dokumentat ngjitur Urdher Shpenzimit :

Emertimi	Nr. Dokument	Date Dokumenti
Cek		
Xhirim		
Nr i Urdherit te blerjes		
Te tjera (Emertime, numer date)	U.BRENDSHEM nr.58 dt.18,06,2012 VKB nr.14 dt.12,03,2012 Sh.ligjsh nr.608 dt.27,03,2012 Akt themelimi nr.1220 nr.868 kol dt.28,8,2011 Ekstrakti i QKR dt.15,06,2012 Vendim zmadhimi kapitali nr.4 dt.3,05,2012	

PER INSTITUCIONIN

URDHERUESI

[Signature]
Vula

KONTABILISTI

[Signature]
Vula

PER DEGEN E THESARIT

Aprovuar date 18.6.2012

NEPUNESI I THESARIT

[Signature]
Vula

Shenim: Qelizat per "Nr. i kuponit" dhe "Aprovuar date", plotesohen nga nepunesi i Deges se Thesarit
Formati i ketij Urdher Shpenzimi eshte miratuar nga Ministri i Financave me shkresen nr. 6153 date 27.05.2009

Applikanti *Fatos Gjyzezi*

[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
SHKODËR

Bashkia Shkodër, Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër; Tëll +355 224 7273 keshilli.bashkiak@yahoo.it

V E N D I M

Nr. 90, datë 30.10.2012

Miratim ndryshim destinacioni te shpenzimeve brenda fondit te miratuar me VKB nr. 14 dt. 12.03.2012(Buxheti i Bashkise)

Këshilli i Bashkisë Shkodër në mbledhjen e tij të dt. 31.07.2012, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Bashkisë, miratoi ne parim **ndryshim destinacioni te shpenzimeve brenda fondit te miratuar me VKB nr. 14 dt. 12.03.2012** kete në mbështetje të ligjit nr.8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 19 pika 9, neni 32 pika d, neni 33 pika 2, me ndryshimet perkatese, te ligjit nr. 9936 dt. 26.06.2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor", te ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" neni 135 dhe 137, te Statusit te KF Vllaznia sh.a. neni 9, si dhe te VKB nr. 14 dt. 12.03.2012 "Miratim i buxhetit te Bashkise per vitin 2012", **gjate mbledhjes se dt. 30.10.2012 zbardhet vendimi i miratuar ne parim.** Pra Keshilli i Bashkise:

V E N D O S I

1. Te miratoje ndryshimin e destinacionit te shpenzimeve brenda fondit te miratuar me VKB nr. 14 dt. 12.03.2012, sipas zerave te shpenzimeve me poshte:

Paksim

Programi 9240 (Art 602) Bashkia Shkoder	7.953.000 leke
Programi 1110 (Art 600) Bashkia Shkoder	7.047.000 leke

Shtese

Programi 8140 (Art 604) Bashkia Shkoder	15.000.000 leke
--	------------------------

Qe do perdoren per zmadhimin e kapitalit themeltar ne emetimin e aksioneve te reja per KF Vllaznia sh.a, 15 000 (pesembedhete mije) aksione me vlere nominale te pandryshuar prej 1000 (nje mije) leke per aksion.

2. Emerimi i zj. Eftalie Qirjaqi si ekspert kontabel e autorizuar.
3. Autorizohet Kryetari i Bashkise Shkoder te nenshkruaj aktet perkatese te Asamblese se pergjithshme te KF Vllaznia Sh.a
4. Ngarkohet per zbatimin e ketij vendimi Kryetari i Bashkise Shkoder.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas shpalljes së ligjshmërisë nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Shkoder.

KRYETARI

Bardhyl LOHJA



Klubi i Futbollit VLLAZNIA sh . a
Asambleja e Pergjithshme

Adresa : Stadiumi Loro Boriçi, Rr. Djepaxhijej, Nr. 2 Shkoder / Albania

Tel: +355 2224 2305; Fax: +355 222 47514 / 43720

V E N D I M

Nr 6 , Dt. 02.11.2012

Sot me datë 02.11.2012, Unë, Lorenc LUKA, me cilësinë e përfaqesut të aksionari te të vetëm Bashkia Shkoder të shoqërisë aksionare „Klubi i Futbollit Vllaznia“ sh.a, e regjistruar si person juridik në QKR me date 29.08.2011 me NUIS – L17029001S, me seli në Rr. Djepaxhijej, Nr. 2, Shkoder, në mbështetje te nenit 135, 173 te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 „Per tregtaret dhe shoqërite tregtare“, nenit 9 te Statutit te K.F.Vllaznia“, sh.a, si dhe të vendimit Nr. 90, date 30.10.2012 te Keshillit te Bashkise Shkoder,

V E N D O S A

1. Zmadhimin e kapitalit themeltar të shoqërisë aksionare „K.F.Vllaznia“ sh.a, me vlere 15.000.000 (pesembedhete milion) leke.
2. Kjo shumë do të transferohet brenda muajit Nentor 2012.
3. Kapitali themeltar rritet me 15.000 (pesembedhete mije) aksione të së njëjtes kategori me vlere nominale të pandryshueshme 1.000 (njemije) leke për aksion.
4. Numri total i aksioneve bëhet 316.900,00 (treqind e gjashtembedhete mije e nëntëqind) me vlere nominale të pandryshueshme 1.000 (njemije) leke për aksion.
5. Emerimin si ekspert kontabel te autorizuar Zj. Eftalie Qirjaqi.
6. Ngarkohet administratori ligjor i shoqërisë aksionare „K.F.Vllaznia“ sh.a, z. Fatos Gjyrezi të depozitoje kete vendim pranë QKR-së së bashku me vendimin Nr. 90, datë 30.10.2012 të Këshillit të Bashkise Shkodër.

Aksionari i vetem i shoqërisë
Bashkia Shkoder
përfaqesuar nga Kryetari

Lorenc LUKA



oni
verisjes
(TDO)

Bashkia Shkoder
K36813001H
2141001
141
3333

Nr. i Kuponit 228 196

URDHER - SHPENZIMI

NR. 781

DATE 6,11,2012

r.i Punonjseve

r.	Struktura e llogarive						SHUMA ne Leke	Objekti i shpenzimit
	Gr.	Kap.	Kod Program	Llogaria Ekonomik	Nen Llogaria	Kod Projekti		
1	0	5	8140	604	6040009		15.000.000,00	Pagese fondi per zmadhim kapitali themeltar
2								
3								
4								
5								
5								
7								
8								
9								
0								
1								
2								

TOTALI ME SHIFRA

15.000.000,00

X

TOTALI ME FJALE


pesembehjetemilion


Te dhena per kreditorin perfitesues :

mri i perfitesit	
lubi Futbollit Vllaznia sha	
Nipt	L17029001S
IAN	AL75206510170000600313237100
mri Bankes	Tirana Bank
Adresa e Bankes	Shkoder

Dokumentat ngjitur Urdher Shpenzimit :

Emertimi	Nr. Dokument	Date Dokumenti
Çek		
Xhirim		
Nr i Urdherit te blerjes		
Te tjera	U.brend nr.93 dt.5,11,2012	
(Emertime, numer date)	VKB nr.14 dt.12,03,2012 "detajimi buxhetit 2012 fq.110"	
	Sh.ligjsh nr.608 dt.27,03,2012	
	Akt themelimi nr.1220 nr.868kol dt.28,8,2011	
	Statusi i shoqerise nr.rep 1221 nrkol 869 dt.26,8,2011	
	VKB nr.90 dt.30,10,2012 sh.ligjsh nr.1838/1 dt.30,10,2012	
	Vendim zmadhimi kapitali nr.6 dt.2,11,2012	

PER INSTITUCIONIN

URDHERUESI
[Signature]
 Vula

PER DEGEN E THESARIT
 Aprovuar date 6.11.2012
NEPUNESI I THESARIT
[Signature]
 Vula


nenim: Qelizat per "Nr. i kuponit" dhe "Aprovuar date", plotesohen nga nepunesi i Deges se Thesarit
 Formati i ketij Urdher Shpenzimi eshte miratuar nga Ministri i Financave me shkresen nr. 6153 date 27.05.2009

Aplikant: *Fatos Gjirezi* *[Signature]*



Klubi i Futbollit VLLAZNIA sh.a
Asambleja e Pergjithshme

Adresa : Stadiumi Loro Boriçi, Rr. Djepraxhij, Nr. 2 Shkoder / Albania

Tel: +355 2224 2305; Fax: +355 222 47514 / 43720

VENDIM

Nr. 01, Date 21.01.2013

Sot me datë 21.01.2013, Unë, Lorenc LUKA, me cilësinë e përfaqësuesit të ortakut të vetëm Bashkia Shkoder të shoqërise aksionare „Klubi i Futbollit Vllaznia” sh.a, e regjistruar si person juridik në QKR me date 29.08.2011 me NUIS – L17029001S, me seli në Rr. Djepraxhij, Nr. 2, Shkoder, në mbështetje të nenit 135, 173 të ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 „Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, nenit 13 të Statutit të K.F.Vllaznia sh.a, si dhe të vendimit Nr. 172, date 28.12.2012 „Miratim zmadhim kapitali të K.F.Vllaznia sh.a”,

VENDOSA

1. Zmadhimin e kapitalit themeltar të shoqërise aksionare „K.F.Vllaznia” sh.a, me vlerën prej 20.000.000 (njëzet milion) leke, duke nënshkruar 20.000 (njëzet mijë) aksione me vlerë nominale, 1000 lek për aksion.
2. Aksionet do të shlyhen nga Aksionari i vetëm Bashkia Shkoder gjatë vitit 2013.
3. Kjo shumë do të transferohet në dy këste, kësti i parë prej 10.000.000 (dhjetë milion) leke në Janar 2013 dhe kësti i dytë prej 10.000.000 (dhjetë milion) leke në Korrik 2013.
4. Kapitali themeltar rritet me 20.000 (njëzet mijë) aksione të së njëjtes kategori me vlerë nominale 1000 (njemijë) leke për aksion.
5. Depozitim nga ana e administratorit ligjor të shoqërise aksionare „K.F.Vllaznia” sh.a, të këtij vendimi pranë QKR-së se bashku me vendimin Nr. 172, date 28.12.2012 të Këshillit të Bashkise Shkodër.

Ortaku i vetëm i shoqërise
Bashkia Shkoder
përfaqësuar nga Kryetari
Lorenc LUKA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
SHKODËR

Bashkia Shkodër, Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër; Tel +355 224 7273 keshilli.bashkiak@yahoo.it

Nr. 172 prot.

Shkodër, me 03.01.2013

Lënda: Dërgim Vendimi

Drejtuar: Prefektura e Qarkut Shkodër

Drejtoria Ekonomike

Drejtoria Juridike

Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Sportit

KF Vllaznia sh.a.

Zyra e informimit dhe marrëdhënieve me publikun

Bashkëlidhur Ju dërgojmë Vendimin e Këshillit të Bashkisë Shkodër.

Vendimi nr. 172, datë 28.12.2012

Sekretare e Këshillit

Ilirjana PIRANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
SHKODËR

Bashkia Shkodër, Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër; Tel +355 224 7273 keshilli.bashkiak@yahoo.it

VENDIM

Nr. 172, datë 28.12.2012

“Miratim zmadhim kapitali të K.F. Vllaznia sh. a”

Këshilli i Bashkisë Shkodër në mbledhjen e tij të dt. 28.12.2012, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të ligjit nr.8652 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, neni 32, pika d, neni 33 pika 2, Ligjit nr. 9901 dt. 14. 04. 2008, neni 135 dhe neni 173 “Për shoqëritë tregtare” i ndryshuar, si dhe mbështetur në buxhetin e vitit 2013, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratohet zmadhimin e kapitalit themeltar të KF Vllaznia sh. a. me vlerën 20.000.000 (njëzet milion) lekë, të parashikuar në buxhetin e vitit 2013 për KF Vllaznia sh.a, duke nënshkruar 20.000 (njëzet mijë) aksione me vlerë nominale, 1000 (njemijë) lekë për aksion.
2. Aksionet do të shlyhen nga aksioneri Bashkia Shkodër gjatë vitit 2013. Fondi prej 20 milion lekë do të transferohet në llogari të KF Vllaznia sh.a në dy këste. Kësti i parë prej 10 milion lekë do të transferohet në llogari të KF Vllaznia sh.a në dy këste. Kësti i dytë prej 10 milion lekë në korrik 2013.
3. Për nënshkrimin e akteve përkatëse ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe KF Vllaznia sh.a
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe KF Vllaznia sh.a
5. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes së ligjshmërisë nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër.



KRYETARI

Bardhy LOHJA

[Signature]

*Nr 172 prot
dt 21.01.13*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QARKU SHKODËR
PREFEKTI

Nr.36/1.Prot

Shkodër më, 16.01. 2013

Lënda: Lidhur me vendimin nr.172 datë 28.12.2012 të Këshillit të Bashkise Shkodër.

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Shkodër.

Prefekti i qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale përcaktuar në dispozitat e ligjit nr.8927, datë 25.07.2002 “Për Prefektin”, neni 14, paragrafi 2, ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, neni 19, neni 32, pika dh, neni 33/3, ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 135,145,173, ligjit nr.9936 dt.28.08.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetore”, i ndryshuar, neni 44, neni 45, ligjit nr.119/2012 dt.17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, Udhëzimit nr.2 dt.6.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, shqyrtoi vendimin nr.172 dt.28.12.2012 të Këshillit të Bashkisë Shkodër me titullin “Miratim zmadhim kapitali të Klubit të futbollit Vllaznia sh.a me shumën prej 20.000.000 (njëzet milion) lekësh, duke nënshkruar 20.000 (njëzet mijë) aksione me vlerë nominale 1000 (njemijë) lekë për aksion. Aksionet do të shlyhen nga aksioneri Bashkia Shkodër gjatë vitit 2013. Fondi prej 20 milion lekësh do të transferohet në llogari të KF Vllaznia sh.a në dy këste. Kësti i parë prej 10 milion lekësh në Janar të vitit 2013 dhe kësti i dytë prej 10 milion lekësh në korrik 2013”.

Pas shqyrtimit ligjor, Prefekti ju autorizon të procedoni konform procedurave të metejshme ligjore.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.



PREFEKTI

Voliana ADEMI

[Signature]



“TËTOHET NJESIA E ORIGINJALIN KRYETARI LORENC LUKA 2/01/2013”



Klubi i Futbollit VLLAZNIA sh.a
Asambleja e Pergjithshme

Adresa : Stadiumi Loro Boriçi, Rr. Djepaxhijej, Nr. 2 Shkoder / Albania

Tel: +355 2224 2305; Fax: +355 222 47514 / 43720

V E N D I M

Nr. 02, Date 14.02.2013

Sot me datë 14.02.2013, Unë, Lorenc LUKA, me cilësinë e përfaqësuesit të ortakut të vetëm Bashkia Shkoder të shoqërise aksionare „Klubi i Futbollit Vllaznia“ sh.a, e regjistruar si person juridik në QKR me date 29.08.2011 me NUIS – L17029001S, me seli në Rr. Djepaxhijej, Nr. 2, Shkoder, në mbështetje të nenit 135, 173 të ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 „Per tregtaret dhe shoqërite tregtare“, nenit 13 të Statutit të K.F.Vllaznia sh.a, si dhe të vendimit të Keshillit të Bashkise Shkoder Nr. 2, date 30.01.2013 “Per miratim zmadhim kapitali të shoqërise aksionare K.F.Vllaznia sh.a”,

V E N D O S A

1. Zmadhimin e kapitalit themeltar të shoqërise aksionare „K.F.Vllaznia“ sh.a, me vleren prej 10.000.000 (dhjete milion) leke, duke nenshkruar 10.000 (dhjete mije) aksione me vlerë nominale, 1000 lek për aksion.
2. Aksionet do të shlyhen nga Aksionari i vetem Bashkia Shkoder gjate vitit 2013.
3. Kapitali themeltar rritet me 10.000 (dhjete mije) aksione të së njëjtes kategori me vlerë nominale 1000 (njemije) leke për aksion.
4. Depozitim të ana e administratorit ligjor të shoqërise aksionare “K.F.Vllaznia” sh.a, të këtij vendimi pranë QKR-së se bashku me vendimin Nr. 2, date 30.01.2013 të Këshillit të Bashkise Shkoder.

Ortaku i vetem i shoqërise
Bashkia Shkoder
përfaqësuar nga Kryetari
Lorenc LUKA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
SHKODËR

Bashkia Shkoder, Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkoder; Tëll +355 224 7273 keshilli.bashkiak@yahoo.it

V E N D I M

Nr. 2, datë 30.01.2013

Per miratim zmadhim kapitali të shoqërise aksionare “K.F.Vllaznia” sh.a

Keshilli i Bashkise Shkoder ne mbledhjen e tij të dates 30.01.2013, me propozim të Kryetarit të Bashkise Shkoder, ne mbështetje të nenit 32 pika d, nenit 33 pika 3, të ligjit nr. 8652, date 31.07.2000 “Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, nenit 135 dhe 173 të ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqërite tregtare”, të ndryshuar, ligjit nr 119/2012 “Per buxhetin e vitit 2013” Udhëzimi nr. 2 date 6.2.2012 “Mbi procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, mbasi shqyrtoi materialin e paraqitur dhe mbas diskutimit të anetareve

V E N D O S I

1. Të miratoje zmadhimin e kapitalit themeltar të “K.F.Vllaznia” sh.a me vleren 10.000.000 (dhjete milion) leke për “K.F.Vllaznia” sh.a, duke nenshkruar 10.000 (dhjete mije) aksione me vlerë nominale 1000 lek për aksion.
2. Aksionet do të shlyhen nga Aksionari Bashkia Shkoder gjate vitit 2013.
3. Kapitali themeltar i “K.F.Vllaznia” sh.a rritet me 10.000 (dhjete mije) aksione.
4. Burimi i financimit është fondi nga Granti shtese për vitin 2013.
5. Autorizohet Kryetari i Bashkise Shkoder për nenshkrimin e akteve perkatese.
6. Per zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkise Shkoder dhe “K.F.Vllaznia”, sh.a
7. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

KRYETARI

Bardhy LOHJA



*Na 2/prot
dt 07.02.13*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QARKU SHKODËR
PREFEKTI

Nr.204/1.Prot

Shkoder më, 4.02. 2013

Lënda: Lidhur me vendimin nr.2 datë. 30.01.2013 të Këshillit të Bashkise Shkoder.

Drejtuar: Këshillit të Bashkise Shkoder.

Prefekti i qarkut Shkoder në zbatim të detyrave të tij funksionale përcaktuar në dispozitat e ligjit nr.8927, datë 25.07.2002 “Për Prefektin”, neni 14, paragrafi 2, ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, neni 19, nenit 32, pika dh, neni 33/3, ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 “Për tregtaret dhe shoqërite tregtare”, i ndryshuar, neni 135,145,173, ligjit nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar, neni 44, neni 45, ligjit nr.119/2012 dt.17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, Udhëzimit nr.2 dt.6.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, shqyrtoi vendimin nr.2 dt.30.01.2013 të Këshillit të Bashkise Shkoder: “Mbi zmadhimin e kapitalit themeltar të Klubit të futbollit Vllaznia sh.a me shumën prej 10.000.000 (dhjete milion) lekësh,duke nënshkruar 10.000 (dhjete mije) aksione me vlerë nominale 1000 (njemije) lekë për aksion. Burimi i financimit është fondi nga granti shtesë për vitin 2013”.

Pas shqyrtimit ligjor, Prefekti ju autorizon të procedoni konform procedurave të mëtejshme ligjore.



Institucioni: Bashkia Shkoder
 NIPIT - i: 336813001H
 Kod Institucion: 3141001
 Entiteti i Qeverisjes: 141
 Distrikti (TDO): 3333

Nr. i Kuponit: 211761

URDHER - SHPENZIMI

NR. 132

DATE 21.02.2013

Nr. i Punoajseve:

Nr.	Struktura e llogarive						SHUMA ne Leke	Objekti i shpenzimit
	Gr.	Kap.	Kod Program	Llogaria Ekonomik	Nen Llogaria	Kod Projekti		
1	0	5	8140	604	6040009	10.000.000.00	pagese fondi per zmadhim kapitali themeltar	
2							Kesti II- viti 2013	
3								
4								
5								
6								
7								
8								
9								
10								
11								
12								
TOTALI ME SHIFRA						10.000.000.00	X	
TOTALI ME FJALE							<i>dhjete milion</i>	

Te dhena per kreditorin perfitues:
 Emri i perfituesit: KLUBI FUTBOLLIT VLLAZNIA S.H.A
 Nipt: L17029001S
 Nr. llog. bank: AL75206510170000600313237100
 Emri Bankes: Tirana Bank
 Adresa e Bankes: Shkoder

Dokumentat ngjitur Urdher Shpenzimit:

Emertimi	Nr. Dokument	Date Dokumenti
Çek		
Xhirim		
Nr i Urdherit te blerjes		
U. Brendshem	27	20.02.2013
VKB	168, dt. 28.12.12	Sh.Ligjsh 32/1 dt. 11.01.13
VKB	172, dt. 28.12.12	Sh.Ligjsh 36/1 dt. 16.01.13
VKB	2, dt. 30.01.13	Sh.Ligjsh 204/1, dt. 04.02.13
Akt themelimi i Shoqerise nr1220,nr868kol,dt.28.8.11		
Statuti i shoqerise nr rep 1221,nr kol 869, dt.26.8.11		
Vendim Zmadhimi kapitali themeltarNr 2, dt.14.02.2013		
Ekstrakt QKR	Date	20.02.2013

PER INSTITUCIONIN

PER DEGEN E THESARIT

URDHERUESI: [Signature]
 KONTABILISTI: [Signature]
 Vula: [Stamp]

Aprovuar date: 21.02.2013
 NEPUNESI I THESARIT: [Signature]
 Vula: [Stamp]

henim. Celizat per "Nr. i kuponit" dhe "Aprovuar date", plotesohen nga nepunesi i Deges se Thesarit
 Formati i ketij Urdher Shpenzimi eshte miratuar nga Ministri i Financave me shkresen nr. 6153 date 27.05.2009

[Signature]



Klubi i Futbollit Vllaznia sh.a.

Adresa: Stadiumi Loro Boriçi, Rr. Djepaxhiej, Nr. 2 Shkoder, Tel: +355 2224 2305, Fax: +355 22247514/43720

VENDIM

Nr. 04 Date 14.05.2013

Per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise aksionare "K.F.Vllaznia" sh.a

Sot, me date 14.05.2013, une Lorenc LUKA, me cilesine e perfaqsesit te ortakut te vetem Bashkia Shkoder te shoqerise aksionare "Klubi i Futbollit Vllaznia", sh.a. e regjistruar si person juridik ne QKR, me NUIS- L17029001S, me seli ne Rr. Djepaxhiej, Nr. 2, Shkoder, ne mbeshtetje te nenit 135, 173 te ligjit nr. 9901, date 14.08.2008 "Per tregtare dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar, nenit 13 te Statutit te kesaj shoqerise, Vendimit nr. 48, date 26.04.2013 te Keshillit Bashkiak Shkoder "Per zmadhimin e kapitalit te shoqerise aksionare "K.F.Vllaznia sh.a",

VENDOSA

1. Zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise aksionare "K.F.Vllaznia" sh.a., me vleren prej 2.000.000 (dy milion) leke, duke nenshkruar 2000 (dy mije) aksione me vlere nominale, 1000 lek per aksion.
2. Aksionet do te shlyhen nga Aksionari Bashkia Shkoder, brenda muajit Maj 2013.
3. Kapitali themeltar i K.F.Vllaznia sh.a.a rritet me 2000 aksione.
4. Depozitimimin e ketij vendimi ne QKR, bashke me vendimin nr. 48, date 26.04.2013 te Keshillit Bashkiak Shkoder.
5. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Administratori i "K.F. Vllaznia" sh.a.

Aksionari i vetem i shoqerise
Bashkia Shkoder
perfaqesuar nga Kryetari

Lorenc LUKA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI BASHKIAK SHKODËR

Bashkia Shkodër, Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër,

Tel +355 22 400 206

VENDIM

Nr. 48, datë 26.04.2013

Per zmadhimin e kapitalit te shoqerise aksionare "K.F.Vllaznia" sh.a.

Keshilli i Bashkisë Shkodër në mbledhjen e tij të datës 26.04.2013, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 32 pika "d", nenit 33 pika 3 te ligji nr. 8652 date. 31.07.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", te ndryshuar, nenit 135 dhe 173 te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtare dhe shoqerite tregtare", te ndryshuar, Udhëzimit nr. 2, date 06.02.2012 "Mbi procedurat dhe standartet e zbatimit te buxhetit", ligjit nr. 119/2012, date 17.12.2012 "Per buxhetin e vitit 2013", ligjit nr. 10 296, date 08.07.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin", VKB nr. 168, date 28.12.2012 "Miratim i buxhetit te vitit 2013",

VENDOSI

1. Miratimin e zmadhimit te kapitalit themeltar te shoqerise aksionare "K.F.Vllaznia" sh.a., me vleren 2.000.000 (dy milion) leke, duke nenshkruar 2000 (dy mije) aksione me vlere nominale 1000 leke per aksion.
2. Aksionet do te shlyhen nga Aksionari Bashkia Shkoder, brenda muajit Maj 2013.
3. Kapitali themeltar i "K.F.Vllaznia" sh.a., rritet me 2000 (dy mije) aksione.
4. Burimi i financimit eshte Buxheti i Bashkise Shkoder, si me poshte:
 - Bashkia Shkoder programi 6260, pakesohet zeri investime "Restaurim fasada rruga 13 Dhjetori e 28 Nentori", shuma 2.000 mije leke.
 - Bashkia Shkoder programi 8140, shtohet zeri transferime te brendshme, shuma 2.000 mije leke.
5. Autorizohet Kryetari i Bashkise Shkoder per nenshkrimin e akteve perkatese.
6. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkise dhe K.F.Vllaznia sh.a.
7. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

KRYETARI

Bardhyl LOHJA



18/1 oct-9.5.2013



REPUBLIKA E SHQIPËRISË QARKU SHKODËR PREFEKTI

Nr.853/1.Prot

Shkodër më, 9.05. 2013

Lënda: Lidhur me vendimin nr.48 datë. 26.04.2013 të Këshillit të Bashkisë Shkodër.

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Shkodër.

